RREGULLORE
Nr.1, date 22.11.2002

PER PROCEDURAT DHE KRITERET E LICENCIMIT TE VEPRIMTARISE: AGJENCI TURISTIKE UDHETIMI DHE AGJENCI TE TRANSPORTIT TURISTIK

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

OBJEKTI I RREGULLORES DHE FUSHA E VEPRIMIT

Neni 1

Kjo rregullore percakton dhe shtrin fushen e veprimit te saj ne:

1. organizimin dhe funksionimin e strukturave qe merren me procedurat e licencimit te subjekteve;
2. klasifikimin e veprimtarise turistike, perkatesisht ne ushtrimin e kesaj veprimtarie si agjenci turistike udhetimi dhe ne ate te transportit turistik;
3. kushtet dhe kriteret qe duhen plotesuar per tu pajisur me licence per keto veprimtari;
4. te drejtat qe kane personat fizike dhe juridike per t'u pajisur me licence si dhe detyrimin e Ministrise se Rregullimit te Territorit dhe Turizmit per trajtim konform dispozitave ligjore te kerkesave te tyre.

Neni 2

Asnje subjekt nuk lejohet te ushtroje veprimtari turistike si agjenci turistike udhetimi dhe ne ate te transportit turistik ne rast se nuk disponon licence.

Neni 3

Objekti i veprimtarise turistike

Objekt i veprimtarise turistike si agjenci turistike udhetimi, konsiderohen kryerja e sherbimeve turistike ndaj klienteve turiste vendas dhe te huaj, individuale ose te organizuar ne grupe, te programuara paraprakisht ose sipas deshires se klienteve turiste dhe kryesisht:

a) - organizimi i udhetimeve per pushime individuale ose kolektive;
- organizimi i pritje-percjelljes se turisteve, sherbimi i guides, perkthyesit, etj;
- organizimi i vizitave ne qytete, muze, monumente historike dhe kulturore,ekskursione ne natyre, shfaqje dhe spektakle muzikore ose kulturore etj;
- dhenia e informacioneve per udhetime dhe pushime turistike;

b) - rezervimi i vendeve te fjetjes ne njesite akomoduese turistike, si dhe porositja e ushqimit ne bar - restorante turistike;
- rezervimi i vendeve ne mjetet e transportit turistik, ose venia ne dispozicion me qera pjesore ose totale e ketyre mjeteve;

c) - ndermjetesimi me shitesit kryesore te produktit turistik (tour-operatore).

Per kryerjen e sherbimeve turistike, perfshire ne objektin e veprimtarise se saj,agjencia turistike hyn ne marredhenie dhe lidh marreveshje kontraktore vetem me subjekte juridike ose fizike, vendas ose te huaj, me veprimtari turistike te licencuara qe operojne ne sektorin turistik si akomodim, transport, tour-operatore, etj, te cilet i kryejne dhe i ofrojne sherbimet e ndryshme turistike edhe drejtperdrejte.

Neni 4

Objekt i veprimtarise turistike te transportit turistik per udhetare konsiderohen kryerja e sherbimeve te transportit ndaj klienteve turiste vendas dhe te huaj, individuale ose te organizuara ne

grupe, te programuara paraprakisht ose sipas deshires se tyre, brenda ose jashte vendit dhe kryesisht:

- kryerja e transportit vajtje-ardhje per pushime ne qendra akomoduese;
- vajtje-ardhje drejt pikave te kalimit kufitar;
- vizita dhe ekskursione brenda qytetit, muzeume, qendra arkeologjike, objekte historiko-kulturore dhe fetare, qendra atraktive turistike, etj.;
- transport per qellime turistike te tjera.

Veprimtaria turistike e transportit turistik per udhetare realizohet mbi bazen e marreveshjeve ose kontratave te arritura ndermjet personave juridike ose fizike te pajisura me licence per ushtrim te kesaj veprimtarie dhe personave juridike ose fizike qe porositin kryerjen e sherbimeve te tilla turistike, si agjenci turistike udhetimi, tour-operatore, njesi akomoduese turistike, si dhe me marreveshje te drejtperdrejte me klientet udhetare.

Neni 5

Licenca e ushtrimit te veprimtarise turistike si agjenci turistike udhetimi ose transport turistik jepet:

Me afat njevjeçar, per lejimin e fillimit te ushtrimit te veprimtarise turistike si agjenci turistike udhetimi ose transport turistik dhe riperterihet per lejimin e vazhdimit te ushtrimit te veprimtarise, vetem atehere kur treguesit ekonomiko-finaciare dhe statistikore te ushtrimit vjetor, pasqyrojne vazhdimesine e veprimtarise turistike, si dhe kur subjekti kerkues ploteson kerkesat dhe detyrimet e parashikuara ne kete rregullore.

Me afat 3-vjeçar, mund te jepet per lejimin e vazhdimit te ushtrimit te veprimtarise turistike si agjenci turistike udhetimi ose transport turistik, vetem atehere kur treguesit ekonomiko-financiar dhe statistikore gjate 2 viteve te meparshme te ushtrimit vjetor, pasqyrojne rritjen dhe qendrueshmerine e rezultateve te veprimtarise turistike, si dhe kur subjekti kerkues ploteson kerkesat dhe detyrimet e parashikuara ne kete rregullore.

KREU II
ORGANIZIMI I STRUKTURAVE FUNKSIONALE DHE PROCEDURAT ADMINISTRATIVE PER MARRJEN E LICENCAVE PER USHTRIMIN E VEPRIMTARISE TURISTIKE

Neni 6

Proçedurat administrative per pranimin dhe shqyrtimin e kerkesave te subjekteve per marrjen e licences se ushtrimit te veprimtarise turistike, dhenien, riperteritjen, refuzimin ose heqjen e licences, mbikqyrjen e ushtrimit te veprimtarise turistike ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, etiken ne turizem dhe dispozitat e kesaj rregulloreje, ndiqen nga Drejtoria qe mbulon aktivitetin e Marketing - Promocionit dhe Standardeve Turistike dhe Drejtoria qe mbulon aktivitetin e liçensimit ne MRRTT.

Neni 7

Drejtoria qe mbulon aktivitetin e Marketing - Promocionit dhe Standardeve Turistike ka te drejten dhe detyren funksionale:

- orientimin, ndjekjen dhe mbikqyrjen e veprimtarise turistike per ushtrimin e saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, etiken ne turizem, dispozitat e kesaj rregulloreje, si dhe kerkesat profesionale bashkekohore ne sektorin e agjencive turistike te udhetimeve dhe te transportit turistik;
- shqyrtimin dhe vleresimin e kerkesave te subjekteve per liçensim;
- verifikimin per plotesimin e kritereve, kushteve per liçensimin e veprimtarise dhe per permbushjen e detyrimeve te percaktuara ne kete rregullore;
- perpilon proçesverbalin vleresues per aprovimin pse refuzimin e kerkeses se subjektit per marrjen ose riperteritjen e licences;
- propozon per dhenien ose refuzimin e licences, ne varesi te plotesimit ose mosplotesimit te kritereve dhe kushteve te percaktuara ne kete rregullore;
- propozon per heqjen ose pezullimin e licences, per shkelje te renda dhe te perseritura ne moszbatimin e detyrimeve te percaktuara ne kete rregullore.

Drejtoria qe mbulon aktivitetin e licensimit ne MRRTT ka te drejte dhe detyre funksionale per:

- komunikimin zyrtar me subjektin gjate tere proçedurave te liçensimit;
- marrjen ne dorezim te kerkeses me dokumentacionin shoqerues, si dhe dhenien e sqarimeve te nevojshme per plotesimin e tij sipas kesaj rregulloreje;
- njoftimin e subjektit per miratimin ose refuzimin e dhenies se licences;
- pergatitjen e licences dhe dorezimin e saj subjektit te liçensuar;
- ruajtjen dhe arshivimin e kerkesave te shqyrtuara, te bashkelidhura me dokumentacionin shoqerues perkates, si dhe te licencave te pavlefshme.

Neni 8

Kerkesa e subjektit quhet zyrtarisht e dorezuar, duke filluar nga data e plotesimit te dokumentave shoqeruese, ligjerisht te rregullta, ne perputhje me kerkesat e kesaj rregulloreje dhe e protokollimit ne regjistrin qe ndodhet ne Drejtorine qe mbulon aktivitetin e liçensimit ne MRRTT.

Neni 9

Dosjet e kerkesave te subjekteve kerkues me dokumentacion te rregullt dhe te plotesuar, dorezohen çdo jave dhe me procesverbal, ne Drejtorine qe mbulon aktivitetin e Marketing-Promocionit dhe Standardeve Turistike, per shqyrtim dhe vleresim.

Neni 10

Drejtoria qe mbulon aktivitetin e Marketing-Promocionit dhe Standardeve Turistike, shqyrton dhe vlereson kerkesat e dorezuara, perpilon process-verbalin vleresues per aprovimin ose refuzimin e kerkeses se subjektit per marrjen ose riperteritjen e licences, process-verbal, i cili nenshkruhet prej Drejtorit te Drejtorise dhe sektorit perkates.

Drejtoria qe mbulon aktivitetin e Marketing-Promocionit dhe Standardeve Turistike, pergatit vendimin per dhenien e licences se ushtrimit te veprimtarise turistike si: agjenci turistike udhetimi ose transport turistik, vendim i cili i shoqeruar me procesverbalin vleresues, i paraqitet per miratim Ministrit ose personit te autorizuar prej tij.

Neni 11

Drejtoria qe mbulon aktivitetin e licencimit ne MRRTT brenda 15 diteve nga marrja e vendimit dhe mbi bazen e tij, njofton zyrtarisht subjektin per miratimin ose refuzimin e kerkeses se tij per licencim dhe pergatit licencen sipas standardeve dhe formateve bashkelidhur kesaj rregulloreje.

Formatet e licencave per ushtrimin e veprimtarise turistike si agjenci turistike udhetimi dhe te transportit turistik jane dokumente standart sipas modelit 1 dhe 2, bashkelidhur kesaj rregulloreje.

Licenca e ushtrimit te veprimtarise turistike si:agjenci turistike udhetimi ose transport turistik nenshkruhet nga Ministri ose personi i autorizuar prej tij.

Licenca permban keto te dhena: emrin e personit juridik ose fizik; emrin e drejtuesit; adresen e selise qendrore dhe te filialeve; te dhena mbi mjetin turistik ne licencen e transportit turistik; data e leshimit dhe afati i licences.

Terheqja e licences duhet te behet prej subjektit brenda 30 diteve nga data e leshimit te saj. Mosterheqja brenda ketij afati shkakton anullimin e saj.

Drejtoria qe mbulon aktivitetin e liçensimit ne MRRTT arshivon praktikat ne nje regjister vjetor sipas muajit te vitit kalendarik te dorezimit. Dokumentacioni ruhet ne kete Drejtori per nje periudhe 10-vjeçare dhe dorezohet, me kalimin e ketij afati, ne arshiven qendrore.

Ne rastin e mosmiratimit te kerkeses se rregullt per marrjen e licences se ushtrimit te veprimtarise turistike, subjektit i lind e drejta e ankeses sipas dispozitave te Kodit te Procedurave Administrative.

Neni 12

Licencat jane subjekt i pageses ne zyren e llogarise se Ministrise qe i leshon ato, kundrejt mandat-arketimit dhe para terheqjes se licences sipas listes te tarifave te miratuara, bashkelidhur kesaj rregulloreje.

Te ardhurat qe grumbullohen nga licencat, shenohen ne nje rregjister te vecante, ne Drejtorine qe mbulon aktivitetin e liçensimit ne MRRTT me te gjitha ekstremet e tyre. Keto te dhena ne fund te muajit i dorezohen zyres se llogarise per te bere rakordimet perkatese.

KREU III
KRITERET DHE KUSHTET QE DUHET TE PLOTESOJNE SUBJEKTET JURIDIKE SIPAS VEPRIMTARIVE NE FUSHAT E TURIZMIT

KAPITULLI I
KRITERET DHE KUSHTET QE DUHET TE PLOTESOJNE SUBJEKTET JURIDIKE PER MARRJEN E LICENCES PER USHTRIMIN VEPRIMTARISE TURISTIKE SI AGJENCI TURISTIKE UDHETIMI

Neni 13

Kerkesa per pajisjen me licencen e ushtrimit te veprimtarise turistike si agjenci turistike udhetimi behet nga drejtuesi ligjor i shoqerise ose nga personi i autorizuar prej tij.

- Licenca si me siper jepet ne emer te personit juridik.
- Subjekti turistik i liçensuar ka te drejte te kete edhe filiale duke i deklaruar ato qe ne fillim te aktivitetit te tyre.
- Per ushtrimin e veprimtarise turistike si agjenci turistike udhetimi ne kushte normale, per te kontaktuar dhe kryer sherbime te ndryshme me klientelen, subjekti kerkues duhet te kete ne pronesi ose qirramarje nje zyre me dy ambjente me nje siperfaqe minimale 16m2 (te dyja) si dhe pajisjet e nevojshme per komunikim si telefon, faks dhe kompjuter.

Neni 14

Drejtori ose administratori i agjencise turistike duhet te zoteroje aftesite e nevojshme profesionale per drejtimin, organizimin dhe funksionimin e agjencise turistike, te vertetuara me dokumente, si vijon:

- diplomen e arsimit te larte;
- deshmi per pervoje pune ose kualifikim profesional ne fushen e turizmit.

Personeli operues i agjencise turistike duhet te jete I specializuar ne kryerjen e veprimeve dhe sherbimeve turistike. Per kete duhet te paraqiten dokumentet si vijon:

- deftesen/diplomen e arsimit te mesem porofesional ose te pergjithshem;
- kontrate punesimi sipas Kodit te Punes;
- leje qendrimi per punonjes me shtetesi te huaj;
- vertetimin e sigurimeve shoqerore.

Neni 15

Per krijimin e besueshmerise ekonomike dhe garantimin e veprimtarise turistike, si kusht per pajisjen me licencen e ushtrimit te veprimtarise turistike si agjenci turistike udhetimi, subjekti kerkues duhet te beje paraprakisht derdhjen si depozite garancie te paprekeshme dhe te ngurtesuar pa afat, ne llogarine e Ministrise se Rregullimit te Territorit dhe Turizmit ne nje prej Degeve te Bankes se Kursimeve, te shumes prej:

- 2000 euro (ose vlefta ne leke sipas kursit bankar te kembimit, diten e derdhjes se depozites bankare) per licence me afat njevjeçar;
- 3000 euro (ose vlefta ne leke sipas kursit bankar te kembimit, diten e derdhjes se depozites

bankare) per licence me afat 3-vjeçar.

Depozita e garancise eshte e paprekshme dhe e ngurtesuar gjate gjithe periudhes se ushtrimit te veprimtarise turistike si agjenci turistike udhetimi. Derdhja dhe kushtet e prekjes se saj percaktohen me akt-marreveshje paraprake midis vete subjektit dhe bankes.

Depozita e garancise mund te terhiqet vetem kur subjekti paraqet zyrtarisht kerkesen me shkrim ne Drejtorine qe mbulon aktivitetin e liçensimit ne MRRTT per mbylljen e veprimtarise turistike, kerkese e cila shqyrtohet prej Drejtorise qe mbulon aktivitetin e Marketing - Promocionit dhe Standardeve Turistike dhe miratohet prej Ministrit.

Neni 16

Subjekti juridik, per marrjen e licences per ushtrimin e veprimtarise turistike si agjenci turistike udhetimi duhet te paraqese dokumentet origjinale ose kopje te noterizuara, si me poshte:

1. formulari-tip me te dhenat e pergjithshme, i plotesuar dhe nenshkruar rregullisht prej perfaqesuesit ligjor te subjektit kerkues, te shoqeruar me dy fotografi te drejtuesit te agjencise turistike, sipas modelit 3, bashkelidhur kesaj rregulloreje;
2. vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane per regjistrimin si person juridik me objekt veprimtarie nder te tjera edhe si agjenci turistike udhetimi;
3. dokumentat vertetues per kualifikimin profesional per drejtuesin, si dhe personelin operues te agjencise turistike;
4. vertetim te gjendjes gjyqesore per drejtuesin ligjor te agjencise turistike (data e deshmise te jete jo me vone se 3 muaj nga data e dorezimit te kerkeses per licence);
5. dokumentin vertetues per pronesine ose qiramarrjen e ambjenteve te zyrave (seline qendrore dhe zyrat perfaqesuese filiale) per periudhen kohore te licences se kerkuar, gent-planin si dhe fotografi per ambientet dhe reklamen e agjencise (data e dokumentit te jete jo me vone se 1 muaj nga data e dorezimit te kerkeses per licence);
6. dokumentin bankar qe verteton derdhjen e depozites se garancise dhe akt - marrveshjen midis vete subjektit dhe bankes;
7. deklarate e subjektit kerkues, i cili merr persiper te zbatoje te gjitha detyrimet dhe dispozitat e percaktuara ne kete rregullore.

Neni 17

Subjektet juridike te licencuara, jane te detyruara (ne cdo 3 muaj) te informojne rregullisht Drejtorine qe mbulon aktivitetin e Marketing-Promocionit dhe Standardeve Turistike, ne perputhje dhe ne zbatim te Ligjit Nr.7687,date 16.3.1993 "Per Statistiken", per te dhenat statistikore mbi veprimtarine e tyre turistike dhe per bashkerendimin e veprimtarive promocionale turistike.

Neni 18

Subjektet juridike te licencuara, jane te detyruara t'i pergjigjen pyetesoreve qe dergohen ne menyre periodike nga Drejtoria qe mbulon aktivitetin e Marketing-Promocionit dhe Standardeve Turistike.

KAPITULLI II
KERKESAT PER RINOVIMIN E LICENCES PER USHTRIMIN VEPRIMTARISE TURISTIKE SI AGJENCI TURISTIKE UDHETIMI

Dokumentet per rinovimin e licencave paraqiten 30 dite para perfundimit te afateve te shenuara mbi dokumetat e mesiperme ose sipas percaktimeve te vecanta qe mund te behen me poshte.

Neni 19

Kerkesen per rinovimin e licences e shoqerojne dokumentet origjinale ose kopje te noterizuara, si me poshte:

1. formulari-tip me te dhenat e pergjithshme, i plotesuar dhe nenshkruar rregullisht prej perfaqesuesit ligjor te subjektit kerkues, te shoqeruar me dy fotografi te drejtuesit te agjencise turistike, sipas modelit 4, bashkelidhur kesa rregulloreje;

2. deklaraten e te ardhurave te realizuara nga aktiviteti turistik per vitin paraardhes, ose per te dy vitet paraardhese ne rastet e kerkesave per licence 3 vjeçare, ne perputhje me dokumentacionin e dorezuar ne organet tatimore;

3. dokumentat per kualifikimin profesional per drejtuesin, si dhe personelin operues te agjencise turistike, ne rast ndryshimi;

4.vertetim te gjendjes gjyqesore per drejtuesin e agjencise. (data e deshmise te jete jo me vone se 3 muaj nga data e dorezimit te kerkeses per licence);

5. dokumentin vertetues per pronesine ose qiramarrjen e ambienteve te zyrave (seline qendrore dhe zyrat perfaqesues filiale) per periudhen kohore te licences se kerkuar per riperterirje dhe, ne rast ndryshimi, gent-planin dhe fotografi per ambientet dhe reklamen;

(data e dukumentit te jete jo me vone se 1 muaj nga data e dorezimit te kerkeses per licence).

6. mandat-arketimet qe vertetojne pagesen e tarifes se sherbimit per rinovimin e licences dhe kontributit vjetor ne fondin promocional turistik;

7. te vertetoje me dokumentacion pjesen e veprimtarise turistike "per numrin e turisteve qe Agjencia Turistike ka trajtuar ne Shqiperi " per rinovimin e licencave 3-vjeçare;

8. deklarate e subjektit kerkues, i cili merr persiper te zbatoje te gjitha dispozitat e percaktuara ne kete rregullore.

Neni 20

Kur subjekti juridik i licensuar do te mbylle veprimtarine turistike si agjenci turistike udhetimi dhe rrjedhimisht, çbllokimin e depozites se garancise bankare, ai duhet te paraqese zyrtarisht dokumentet si me poshte:

- deklarimin zyrtar me shkrim per mbylljen e veprimtarise turistike si agjenci turistike udhetimi te nenshkruar rregullisht ne emer te shoqerise prej drejtuesit ligjor ose administratorit;
- licencen origjinale te ushtrimit te veprimtarise turistike si agjenci turistike udhetimi per vitin fiskal ne vazhdim.

KAPITULLI III
KRITERET DHE KUSHTET QE DUHET TE PLOTESOJNE SUBJEKTET FIZIKE /JURIDIKE PER MARRJEN E LICENCES PER USHTRIMIN E VEPRIMTARISE TURISTIKE TE TRANSPORTIT TURISTIK

Neni 21

Personi fizik ose juridik ka te drejte te paraqese kerkesen e tij per tu pajisur me licencen e ushtrimit te veprimtarise turistike te transportit turistik kur ploteson keto kushte:

- vendimin e gjykates qe verteton se ne objektin e veprimtarise se tij perfshihet ushtrimi i veprimtarise turistike te transportit turistik.
- Disponon ne pronesi ose ne perdorim mjet ose mjete te transportit "turistik"(autobus,minibus, taksi, etj), te pajisura me lejen e qarkullimit rrugor.
- Nuk duhet te jete denuar per vepra penale kunder personit dhe/ose pasurise se shtetasve dhe asaj publike si dhe nuk duhet te jete denuar penalisht per shkelje te Kodit Rrugor.
- Te jete i pajisur me patente drejtimi te kategorise "D".

Ne rast kur mjeti i transportit nuk drejtohet prej vete subjektit kerkues, te njejtat dokumenta te aftesise se drejtimit te mjetit te transportit turistik jane te detyrueshme per drejtuesin e mjetit te transportit te punesuar prej tij.

Neni 22

Ushtrimi i veprimtarise turistike te transportit turistik mund te kryhet vetem me mjete transporti te cilesuara "turistike" per te mundesuar ofrimin e sherbimeve te nevojshme dhe kushteve te

pershtatshme te komfortit gjate transportit per qellime turistike.

Mjetet e transportit, te percaktuara dhe te deklaruara prej subjektit kerkues te licences per kryerjen e veprimtarise turistike te transportit turistik per udhetare, do te cilesohen si "turistike", atehere kur ai verteton plotesimin e kerkesave vijuese :

- mjet ne gjendje te mire teknike dhe i mirembajtur;
- mjet prodhim i viteve te fundit, por jo shume se 10 vjet, ose jo me shume se 400 mije km;
- mjet i pajisur me sistemin e ajrit te kondicionuar;
- mjet i pajisur me paketen sanitare te ndihmes se shpejte;
- mjet i pajisur me mikrofon, (autobuze);
- mjet i pajisur me akt-kontrolli teknik dhe kolaudimi (modeli 020 ose 021) sipas llojit te mjetit te transportit, kategorise se transportit, si dhe lejes per te drejte transporti turistik kombetar ose nderkombetar.

Neni 23

Subjekti, (personat fizike dhe juridike), per marrjen e licences per ushtrimin e veprimtarise turistike te transportit turistik duhet te paraqese dokumentet origjinale ose kopje te noterizuara, si me poshte:

1. formularin-tip bashkelidhur me te dhenat e pergjithshme, te plotesuar dhe nenshkruar rregullisht prej subjektit kerkues, bashke me dy fotografi per subjektin kerkues dhe tre fotografi te mjetit te transportit turistik (me pamje ballore, anesore dhe te brendeshme), sipas modelit 5, bashkelidhur kesaj rregulloreje;
2. vendimin e gjykates se rrethit per rregjistrimin si person juridik ose fizik, me objekt veprimtarie ushtrimin e veprimtarise te transportit turistik per udhetare;
3. dokumentin (patenten) per aftesine e drejtimit te mjetit te transportit turistik per udhetare (sipas llojit dhe kategorise se mjetit te transportit) per vete pronarin, ose drejtuesin e punesuar bashke me kontraten e punesimit (jo me vone se 3 muaj);
4. vertetim te gjendjes gjyqesore. (data e deshmise te jete jo me vone se 3 muaj nga data e dorezimit te kerkeses per licence);
5. dokument mbi pronesine e mjetit te transportit turistik (data e dokumentit te jete jo me vone se 3muaj nga data e dorezimit te kerkeses per licence);
6. aktin e kontrollit teknik dhe kolaudimit te mjetit te transportit turistik per udhetare brenda dhe / ose jashte vendit sipas llojit dhe kategorise se tij (jo me vone se 3 muaj);
7. mandatet e arketimeve qe vertetojne pagesen e tarifes se sherbimit per pajisjen me licence dhe kontributin vjetor ne fondin promocional turistik;
8. raportimin periodik te te dhenave statistikore mbi veprimtarine turistike te transportit turistik;
9. deklarate e subjektit kerkues, i cili merr persiper te zbatoje dispozitat dhe detyrimet e percaktuara ne kete rregullore.

KAPITULLI IV
KERKESAT PER RINOVIMIN E LICENCES PER USHTRIMIN VEPRIMTARISE TURISTIKE TE TRANSPORTIT TURISTIK

Neni 24

Subjekti, (personat fizike dhe juridike), per rinovimin e licences per ushtrimin e veprimtarise turistike te transportit turistik duhet te paraqese dokumentet origjinale ose kopje te noterizuara, si me poshte:

1. formularin-tip bashkelidhur me te dhenat e pergjithshme, te plotesuar dhe nenshkruar rregullisht prej subjektit kerkues, bashke me dy fotografi per subjektin kerkues dhe tre fotografi te mjetit te transportit turistik (me pamje ballore, anesore dhe te brendeshme), sipas modelit 6, bashkelidhur kesaj rregulloreje;
2. vendimin e gjykates se rrethit per rregjistrimin si person juridik ose fizik, me objekt veprimtarie ushtrimin e veprimtarise te transportit turistik per udhetare;

3. dokumentin (patenten) per aftesine e drejtimit te mjetit te transportit turistik per udhetare (sipas llojit dhe kategorise se mjetit te transportit) per vete pronarin, ose drejtuesin e punesuar bashke me kontraten e punesimit (jo me vone se 3 muaj);

4. vertetim te gjendjes gjyqesore.(data e deshmise te jete jo me vone se 3 muaj nga data e dorezimit te kerkeses per licence);

5. dokument mbi pronesine e mjetit te transportit turistik .(data e dokumentit te jete jo me vone se 3 muaj nga data e dorezimit te kerkeses per licence);

6. aktin e kontrollit teknik dhe kolaudimit te mjetit te transportit turistik per udhetare brenda dhe (ose jashte vendit sipas llojit dhe kategorise se tij) (jo me vone se 3 muaj);

7. mandatet e arketimeve qe vertetojne pagesen e tarifes se sherbimit per pajisjen me licence dhe kontributin vjetor ne fondin promocional turistik;

8. raportimin periodik te te dhenave statistikore mbi veprimtarine turistike te transportit turistik;

9. deklarate e subjektit kerkues, i cili merr persiper te zbatoje dispozitat dhe detyrimet e percaktuara ne kete rregullore.

Dokumentet per rinovimin e licencave, paraqiten 30 dite para perfundimit te afateve te shenuara ne licence.

Neni 25

Kur subjekti i licensuar kerkon te mbylle aktivitetin, ai duhet te paraqese ne Drejtorine qe mbulon aktivitetin e liçensimit ne MRRTT dokumentet e meposhtme:

- kerkesen zyrtare ku te deklaroje mbylljen e veprimtarise turistike te transportit turistik;
- licencen origjinale te ushtrimit te veprimtarise turistike te transportit turistik per vitin fiskal ne vazhdim.

KREU IV
PAVLEFSHMERIA E LICENCAVE DHE MASAT DISIPLINORE NDAJ SUBJEKTEVE

Neni 26

Licencat per ushtrimin e veprimtarise si agjenci turistike udhetimi dhe ne ate te transportit turistik behen te pavlefshme, ne rast se subjektet juridike nuk e fillojne veprimtarine per te cilen u jane dhene keto licenca brenda 60 diteve nga data e leshimit te tyre.

Licenca mund te hiqet kur ne veprimtarine e subjekteve si agjenci turistike udhetimi dhe ne ate te transportit turistik konstatohen shkelje te neneve te kesaj rregulloreje qe rregullojne veprimtarine perkatese.

Neni 27

Heqja e se drejtes per ushtrimin e aktivitetit si agjenci turistike udhetimi dhe te transportit turistik apo pezullimin e perkohshem te ketyre veprimtarive, propozohet nga Drejtoria qe mbulon aktivitetin e Marketing Promocionit dhe Standardeve Turistike dhe miratohet nga Ministri.

Masat, sipas shkeljeve te bera gjate ushtrimit te veprimtarise jane me heqje te se drejtes te ushtrimit te aktivitetit te licensuar: 6 muaj, 1 vit, 3 vjet.

Masat e marra i njoftohen subjektit perkates si dhe deges se tatim taksave ku ushtron veprimtarine subjekti.

Neni 28

Per çdo mase te marre ndaj subjekteve, ne zbatim te nenit 26 te kesaj rregulloreje, personat fizike dhe juridike kane te drejten e ankimit sipas dispozitave te Kodit te Procedurave Administrative.

Neni 29

Rregullorja per ushtrimin e veprimtarise se agjencive te udhetimeve turistike, miratuar me shkresen nr.59/1 date 11.11.1998, te Komitetit te Zhvillimit te Turizmit dhe rregullorja per ushtrimin e veprimtarise turistike te transportit turistik, e miratuar me shkresen nr.719 date 4.10.2000 nga Komiteti i Zhvillimit te Turizmit, shfuqizohen.